

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE “TECNOSOLUTIONS” SH.P.K ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 31/08/2022, në Tiranë,

Mimoza Agaçi shtetase shqiptare, e lindur më 10.02.1968 në Rerez, Shqipëri, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr.G85210308B.

Të cilët kanë vendosur themelimin e shoqërisë **TECNOSOLUTIONS Shpk**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria **TECNOSOLUTIONS Shpk** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqësimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **TECNOSOLUTIONS Shpk**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

Software house, zhvillime programesh software, konsulence për zhvillimin e programeve kompjuterike si dhe regjistrimin dhe patentimin e tyre. Mbajtjen e pronësive intelektuale për software-t e zhvilluara.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake Nr.7, Sheshi Karl Topia, Kompleksi 127, Kulla 3, Kati i 2. Tirane.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është i ndarë në 1 kuote.

Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Mimoza Agaçi 1 kuotë, me vlerë 100 Lekë, zotëron 100%

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërisëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë : **Mimoza Agaçi** shtetase shqiptare, e lindur më 10.02.1968 në Rrez , Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr.G85210308B.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhvendojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKËT THEMELUES

Mimoza Agoci
